

**PËRMBLEDHJE**  
**MBI VEPRIMTARINË E SEKTORIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË**  
**DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË ALUIZNI-t, PËR PERIUdhËN**  
**JANAR – dhJETOR 2014.**

**I. Përmbledhje ekzekutive**

Duke ju referuar objektivave të ALUIZNI-t (Agjensia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Informale), të paraqitura në planin e veprimeve si dhe vizionit të saj në nivel strategjik, auditimi i brendshëm do të realizohet për t'i shtuar vlerat dhe për të shërbyer në ndihmë të drejtimit duke vlerësuar situatën e kontrollit të brendshëm, duke vënë në dukje punën e bëre, të metat apo mangësitë dhe duke lënë rekomandime për përmirësime.

Puna e auditit ka konstatuar në sondazhe, intervistim, përpilim dhe mbledhje informacioni nëpërmjet verifikimit të dokumentacionit, pyetësorëve, kontrole të befashme, analiza dhe vlerësime aritmetikore të të dhënave, analiza të efektivitetit, teste dhe çdo lloj tjetër mjeti që ka kryer vlerësimin dhe analizën e veprimeve.

Më konkretisht puna e sektorit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2014 paraqitet si më poshtë:

Gjatë procesit të auditimit të brendshëm, menaxhimi është informuar ***mbi gjetjet e auditimit***. Raportimi i gjetjeve të punës tek menaxhimi i organizatës dhe lënia e rekomandimeve për të përmirësuar funksionimin e organizatës (entitetit publik) është një nga pjesët më të rëndësishme të procesit të auditimit të brendshëm.

Këto rekomandime janë kryesisht të karakterit ligjor, organizativ dhe për zhdëmtim, në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare me synimin për të ulur mundësinë e përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen.

**II. Baza Ligjore**

Nisur nga veçoritë e aktivitetit që ushtron ALUIZNI, forma e organizimit të Drejtorisë, së Përgjithshme, baza ligjore dhe nënligjore që rregullon aktivitetin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm në ALUIZNI-it, është:

- Ligji nr.9720, date 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, (ndryshuar me ligjin nr.10318, date 16.09.2010, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9720, datë 16.9.2010, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.
- Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, miratuar me urdhër të Ministrit Financave nr.69, datë 29.09.2010.
- Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 69, datë 29.09.2012, “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.
- Manuali specifik i Auditimit të Brendshëm të Sektorit të AB të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t me Urdhërin nr. 463, datë 04.11.2011.
- Standartet Ndërkombëtare për praktikën profesionale të Auditimit të Brendshëm,
- Ligji Nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin të zonave/ndërtimeve informale” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në fuqi.

### III. Organizimi

Në dallim të qartë nga disa, apo tërë strukturat që ka krijuar dhe funksionojnë në Drejtorinë e Pergjithshme të ALUIZNI-t, struktura e Auditimit të Brendshëm e gjen ekzistencën e saj, rolin dhe pozitën e saj, papajtueshmërinë e funksionimit me strukturat e tjera, në një ligj organik, siç është ligji nr.9720 datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar.

Ashtu si dhe në dispozitat e tjera paraardhëse që kanë përcaktuar qartë rolin e strukturës së kontrollit të brendshëm edhe kjo dispozitë ligjore tregon qartë ekzistencën e strukturave të auditimit të brendshëm.

Ky ligj tregon qartë misionin e kësaj strukture, që është:

*"Veprimtari e pavarur që jep siguri objektive dhe këshilla për drejtimin, i projektuar për të shtuar vlerën dhe përmirësuar veprimet e subjektit publik, njëkohësisht ndihmon subjektin me anë të një mënyre sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, proceset e kontrollit dhe të qeverisjes"*

Dhe ka si objektiv:

*shqyrtimin, vlerësimin dhe dhënien e rekomandimeve për sistemet e kontrollit të brendshëm dhe transaksionet lidhur me:*

*-rreziqet e brendshme të kontrollit të drejtimit,  
-përdorimin me kursim, dobi dhe frytshmëri të burimeve financiare dhe njerëzore,*

*-shkallën me të cilën rezultatet e programeve të subjektit të audituar plotësojnë objektivat e tij,*

*-pajtueshmërinë e veprimtarisë së subjektit të audituar me legjislacionin në fuqi,*

*-kujdesin për plotësimin e të dhënave financiare dhe të drejtimit, si dhe përdorimin e tyre për mbështjetjen e vendimmarrjes.*

Në këtë ligj del qartë se, realizimi i auditimit (si proces që realizohet nga auditët e strukturës së auditimit të ALUIZNI-t) është i pavarur, në kuptimin që:

Planifikimi, përcaktimi, realizimi dhe raportimi i veprimtarisë së auditimit, është jashtë çdo ndikimi që ka lidhje me veprimtarinë e audituar.

### IV. Rezultatet e veprimtarisë së AB

Në zbatim të kërkesave të nenit 7 të Ligjit 9720, datë 23.04.2007 " Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik ", ndryshuar me Ligjin nr.10318, datë 16.09.2010 dhe të Kapitullit III të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr 69, datë 29.09.2010 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", auditimi i ushtruar ka synuar të përfshijë ato subjekte të cilat lidhen me misionin dhe qëllimin për të cilën ajo funksionon.

Bazuar në pikën 1.5.2 të Kapitullit I, të Manualit, veprimtaria audituese është orientuar në :

Auditimin e sistemeve dhe vlerësimin në thellesi të menaxhimit financiar dhe të kontrollit të vendosura nga niveli i menaxhimit, me qëllim përcaktimin nëse ato funksionojnë me kosto efektive, në menyrë eficiente dhe për arritjen e objektivave.

Proçesi i planifikimit ka vijuar të përmirësohet, duke shfrytëzuar eksperiencat më të mira, si dhe duke respektuar me profesionalizëm standartet e auditimit të brendshëm në fushën e planifikimit. Plani ka orientuar përdorimin e burimeve të auditimit drejt auditimeve të plota e gjithpërfshirëse me qëllim kontribuimin në arritjen e objektivave dhe programeve strategjike të sistemit financiar publik.

Sektori i Auditimit të Brendshëm do të vijojë të përmirësojë efikasitetin e punës së tij, dhe do rrisë asistencën e tij profesionale në ndihmë të përmirësimit të drejtimit dhe shtimit të vlerës së ALUIZNI-t dhe të njësive në vartësi të saj, duke planifikuar për auditim ato Drejtori, aktivitete apo fusha me risk më të lartë pa nënvleftësuar Drejtoritë e tjera të vartësisë.

## V. Rekomandimet.

Gjatë procesit të auditimit të brendshëm, menaxhimi është informuar **mbi gjetjet e auditimit**. Raportimi i gjetjeve të punës tek menaxhimi i organizatës dhe lënia e rekomandimeve për të përmirësuar funksionimin e organizatës (entitetit publik) është një nga pjesët më të rëndësishme të procesit të auditimit të brendshëm.

Bazuar në gjetjet e rezultuara sipas auditimeve me bazë sistemi, pranë entiteteve të audituara, për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe të organizimit të kontrollit të brendshëm, **për periudhën e 12 mujore të vitit 2014, janë dhënë gjithsej 57 rekomandime**, të cilat sipas sistemeve paraqiten:

- a. Sistemi i pagave, është dhënë 1 rekomandim.
- b. Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore, janë dhënë 4 rekomandime.
- c. Sisteme të tjera sipas misionit dhe qëllimit të institucionit, janë dhënë 46 rekomandime.
- d. Sistemi i kontabilitetit dhe menaxhimit financiar janë dhënë 6 masa organizative për zhdëmtim.

Këto rekomandime janë kryesisht të karakterit ligjor, organizativ dhe për zhdëmtim, në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare me synimin për të ulur mundësinë e përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen.

Për periudhën raportuese, zbulimet në vlerë janë rritur në mënyrë të ndjeshme me të njëjtat periudha të viteve të mëparshme, përkatësisht nga **522 000 mijë lekë në vitin 2013**, gjetjet në vlerë me dëm ekonomik në periudhën raportuese **2014, kanë arritur në rreth 1.958.600 lekë**.

Në zbatim të nenit 8, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", vlerësojme se titullarët e kësaj njësie publike, në vijimësi, kanë vendosur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me qëllim përdorimin e fondeve publike me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet. Përgjithësisht sistemi i kontrollit të brendshëm ka funksionuar si një proces integral dhe i vazhdueshëm, duke zbatuar ligjshmërinë dhe aktet ligjore në fuqi, fakt që ka sjell një nivel rrisje në rënie nga viti në vit. Këto evidentohen nga rregullsia financiare me dietat, rregullsia administrative me emërimet, me prokurimin e fondeve, arkëtimin e detyrimeve, etj.

## VI. Konkluzionet.

Për vitin 2015, Sektori i A.B., ka hartuar objektivat afatgjatë të shprehura në planin strategjik 2015-2019, si dhe objektivat afatshkurtër të vitit 2015. Me anën e këtij plani synohet ndjekja e realizimit të rekomandimeve të lëna gjatë auditimeve të kryera. Gjithashtu nëpërmjet auditimeve, Sektori i A.B. do të ndihmojë Drejtoritë e vartësisë në rritjen e numrit të shqyrtimit të dosjeve të legalizimit.

Duke synuar përmirësimin e cilësisë së rekomandimeve si dhe përshtatjen më shtesat ose me ndryshimet ligjore që mund të ndodhin gjatë vitit në vijim, është e rëndësishme që të kryhen kualifikimet e nevojshme për audituesit e Sektorit të A.B. të ALUIZNI-t.